

Pyetje dhe Përgjigje

Tender Nr. 18 – “Shërbimi i sigurisë fizike për nënzonat e trashëgimisë dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit”

(Pyetje) - Në lidhje me pikën nr. 12 *“Autorizim i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për përdorimin e mjeteve speciale për vitin 2025 në vijim”* është kthyer përgjigje lidhur me kategorinë **1.3.B “Shërbimi i sigurimit dhe shoqërimit të vlerave monetare gjatë transportit”**

(Përgjigje) – Ju bëjmë me dije se autorizimi i pikes nr. 12 duhet dorëzohet sikurse përcaktohet në Kërkesën për Tender për përdorimin e mjeteve speciale. Lidhur me kategorinë 1.3.B për *“Shërbimi i sigurimit dhe shoqërimit të vlerave monetare gjatë transportit” nuk kërkohet në këtë tender.*

(Pyetje) - Sqarim për rradhitjen e numrave rendore të dokumentacionit pas pikes 15, faqja nr. 4 e dokumentit “Kërkesë për Blerje”, ku në faqen Nr. 5 është 23.

(Përgjigje) – Pasaktësi e korrigjuar dhe reflektuar në njoftimin përkatës të publikimit për “Saktësim në pikën 1.14.” Lista e dokumentacionit që do të dorëzohet”, për numrat rendorë të dokumentacionit faqe nr. 5, pikat 23, 24 dhe 25 bëhen 16, 17 dhe 18 me të njëjtën përmbajtje”.

(Pyetje) - Sqarim për pikën 2.3 “Informacion Shtesë” nënpika nr. 5, *“Nënkontraktimi nëse është i nevojshëm, lejohet vetëm për krijimin e sallës së monitorimit dhe mirëmbajtjen e sistemit CCTV”* për këtë pike *kërkojmë më shumë detaje teknike* në lidhje me ofrimin e shërbimit.

(Përgjigje) - Lidhur me detajet që kërkohen sugjerojmë ti referoheni pikës 4.2 të Termave të Referencës. Për sqarime të mëtejshme *lutemi specifikoni pyetjet apo paqartësitë që keni.*

(Pyetje) - Në faqen e internetit si afat i fundit për dorëzimin e zarfave është përcaktuar data **17.09.2025 ora 11.00**, ndërsa tek dokumentacioni i tenderit, "Kërkesat për Tender" (KPT)" pika 1.6, është përcaktuar datë **17.09.2025 ora 12.00**. Të përcaktohet nëse është ora 11.00 apo ora 12.00, afati i fundit për dorëzimin e ofertes.

(Përgjigje) - Lidhur me saktësimin e *orarit të dorëzimit* bëjmë me dije se *është ora 11:00, date*

(Pyetje) – Sqarim pas disa ndryshime në dokumentin KPT që të sillen specifikimet termike të uniformave sipas stinëve, bazuar në Udhëzim Nr. 150, Datë 16.8.2024 për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe qendrës së trajnimit privat të punonjësve të shërbimit KREU VIII pjesët e uniformës, paraqitja e punonjësit dhe mjetet sinjalizuese, pamore/zanore. Në udhëzim janë të përcaktuar qartë detajet e uniformave të cilat jemi të detyruar të përdorim.

b) Nëpërmjet kësaj kërkesë Fondacioni kërkon një ilustrim me foto të uniformave që kompania përdor si dhe komfortin termal të tyre marrë parasysh kushtet e punës në park, ekspozim ndaj temperaturave të larta në rast se uniformat kanë veti tilla të parashikuara.